



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT K R Y E T A R I

Nr. 731/8 Prot.

Tiranë, më 19/12/2016

## V E N D I M

**Nr.152, Datë 19/12/2016**

### **PËR EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË BASHKINË VORË "MBI AUDITIMIN E PËRPUTHSHMËRISË DHE LIGJSHMËRISË"**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të neneve 10, 15 dhe 30, të ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

## **V E N D O S A:**

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin e përputhshmërisë dhe ligjshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Vorë, dhe Njësitë Administrative ish-Komuna Bërxull dhe Prezë, për periudhën 01.10.2014 deri më 30.06.2016.

**II.** Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Vorë nuk ka investuar në drejtim të njohjes dhe trajnimit të stafit në fushën e Teknologjisë së Informacionit, për përdorimin e tyre në funksion të administrimit financiar, për rritjen e efektivitetit të përdorimit të informacionit financiar, pasi Zyra e Financës nuk ka krye informatizimin e veprimeve me magazinën, duke mos azhurnuar e ndjekur gjurmën e amortizimit, masa të cilat duhet të merreshin në zbatim të ligjit nr. 9228, datë 24.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare”, VKM nr. 248,

date 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe të njëjstëve që varen prej tyre”, i ndryshuar me VKM Nr. 25 datë 20.01.2001.

**1.1. Rekomandim:** Bashkia Vorë të marrë masa për trajnimin dhe informatizimin e punonjësve për përdorimin e programeve veçanërisht në fushën e administrimit financiar, duke pasur për objektiv rritjen e efektivitetit të përdorimit të informacionit financiar, dhe qëllim ndjekjen e gjurmës të amortizimit të aktiveve.

**Menjëherë**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nëpunësi autorizues nuk ka marrë masa konkrete për të koordinuar punën me strukturat përkatëse për përmirësimin e dokumentacionit, me qëllim evidentimin, klasifikimin dhe ndjekjen në mënyrë të vazhdueshme në rrugë administrative, gjyqësore e përmbartimore të debitorëve, për arkëtimin e detyrimeve, ku nga pamjaftueshmëria e punës së Drejtorisë së Financës, në drejtim të arkëtimit të debitorëve të ndryshëm, gjendja financiare në fund të vitit 2015, është në vlerën **60 480 744 lekë**.

Nëpunësi autorizues nuk ka marrë masa për likuidimin e detyrimeve ndaj kreditorëve, pasi nuk janë paguar detyrimet ndaj “Furnitor e llogari të lidhura me to” të cilat në fund të vitit 2015 kapin vlerën **8 874 204 lekë**.

**2.1. Rekomandim:** Nga Drejtoria e Financës të zbatohet metoda e shpenzimeve dhe e të ardhurave, për njohjen e shpenzimeve korrente dhe kapitale të vitit buxhetor në çastin e ndodhjes së tyre, pavarësisht nga datat e pagesës, konform ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor” dhe ligjit nr. 9228, datë 24.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare”.

**2.2. Rekomandim:** Nga Drejtoria e Financës të marrin masa konkrete duke koordinuar punët me të gjitha strukturat përkatëse, në drejtim të arkëtimit të debitorëve, detyrime të cilat në fund të vitit 2015, janë në vlerën në vlerën **60,480,744 lekë** me një trend rritës, krahasuar me vitin paraardhës, si dhe gjatë përgatitjes së projektbuxhetit korrent dhe projektbuxhetit afatmesëm të parashikojnë detyrimet afatshkurta ndaj të tretëve, të cilat në fund të vitit 2015 rezultojnë në vlerën **8,874,204 lekë**, me një trend rritës krahasuar me vitin paraardhës.

**Menjëherë**

**3. Gjetje nga auditimi:** Raportet finale të auditit të brendshëm dhe masat e rekomanduara nga auditimet e ushtruara megjithëse janë vlerësuar dhe kanë pasur mbështetjen e nevojshme për zbatim nga titullari i institucionit, konstatohet se ende duhet punuar në drejtim të rregullshmërisë së tyre, argumentimit të shkeljeve dhe mbështetjes ligjore, veçanërisht për masat dhe rekomandimet e lëna për eliminimin e të metave.

**3.1. Rekomandim:** Njësia e Auditimit të Brendshëm, gjatë proceseve të auditimit, për të rritur efektivitetin dhe performancën e punës audituese, të vlerësojë më shumë punën në drejtim të rregullshmërisë dokumentare, argumentimit të shkeljeve të konstatuara dhe mbështetjen ligjore për masat dhe rekomandimet për përmirësimin e punës në të ardhmen, si dhe për ndjekjen në vijimësi të realizimit të tyre brenda afateve të përcaktuara.

**Vazhdimisht**

**4. Gjetje nga auditimi:** Për të gjitha asetet e kaluara me VKM në pronësi të Bashkisë Vorë dhe Njësive Administrative Prezë dhe Bërxull është vepruar në kundërshtim me Kapitullin III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 26 dhe 27 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”,

nëpunësi autorizues nuk ka caktuar nëpunësin zbatues për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit kontabël të gjithë aktiveve që zotëron apo ka në administrim. Në kundërshtim me nenin 31/d, nuk është mbajtur regjistri i veçantë për secilën nga pasuritë e dhëna me qira ku të përcaktohet sipërfaqja e objektit në metra katrorë, numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës, afati i qirasë, veprimtaria që kryhet, subjekti përfitues, qiraja mujore dhe arkëtimet sipas muajve të vitit kalendarik.

**4.1. Rekomandim:** Nga ana e Bashkisë Vorë të merren masat dhe të kryhen të gjitha procedurat për mbajtjen e regjistrit kontabël të të gjithë aktiveve që zotëron apo ka në administrim, si dhe regjistri i veçantë për secilën nga pasuritë e dhëna me qira ku të përcaktohet sipërfaqja e objektit, kontrata e qirasë, afati i vlefshmërisë, veprimtaria që kryhet, subjekti përfitues, qiraja mujore, arkëtimet sipas muajve të vitit kalendarik, etj.

#### Në vijimësi

**5. Gjetje nga auditimi:** Për të gjitha asetet, pyjet e kullotat e kaluara me VKM në pronësi apo përdorim të Bashkisë Vorë dhe Njësisë Administrative Prezë dhe Bërçull, nuk është kryer azhurnimi periodik i tyre, si dhe për pyjet e kullotat nuk është bërë procesverbali i dorëzimit nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor, duke bërë që gjendja dokumentare e tyre të mos përputhet me realitetin sipas terrenit, ku një pjesë e tyre nuk ekzistojnë, janë me sipërfaqe të ndryshme nga sa kaluar me VKM, apo kanë kaluar në pronësi të subjekteve me anë të lejeve të legalizimit të lëshuara nga ALUIZNI.

Nuk janë zbatuar plotësisht VKM-të respektive, për kalimin në pronësi të aseteve, pyjeve e kullotave, të cilat kanë ngarkuar NJQV për regjistrimin e të gjitha pasurive në ZVRPP Tiranë, në zbatim të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”. Për të gjitha asetet në pronësi apo përdorim, është vepruar në kundërshti me Kapitullin III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 26 dhe 27 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nëpunësi autorizues nuk ka caktuar nëpunësin zbatues për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit kontabël të të gjithë aktiveve që zotëron apo ka në administrim. Për pronat të cilat rezultojnë të zëna forcërisht, nuk janë marrë masat e nevojshme për lirimin e tyre nga zaptuesit dhe përdoruesit e paligjshëm të tyre.

**5.1. Rekomandim:** Nga ana e Bashkisë Vorë, të merren masat dhe të kryhen të gjitha procedurat për azhurnimin e përditësimin e të gjitha aseteve në pronësi e përdorim, pyjeve e kullotave, për të gjithë territorin administrativ të saj. Në përfundim të këtij procesi të miratohet listinventari aktual i pasurive duke kërkuar miratimin nga Këshilli i Ministrave të listës përfundimtare të pronave të NJQV.

#### Në vijimësi

**5.2. Rekomandim:** Bashkia Vorë, Sektori i Menaxhimit të Pronave dhe Aseteve dhe Zyra e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës, të vijoj të gjitha procedurat ligjore për regjistrimin në ZVRPP të pasurive të kaluara në pronësi, të mbaj dhe përditësoj regjistrin kontabël të aktiveve në pronësi apo administrim, si dhe për ato pasuri të cilat rezultojnë të zëna forcërisht të marrë masat për lirimin e tyre dhe vënin në funksion e përdorim të komunitetit, sipas destinacionit të përcaktuar në VKM apo në vendimet e Këshillit Bashkiak.

#### Në vijimësi

**6. Gjetje nga auditimi:** Për objektin sipas kontratës datë 01.06.1994 lidhur ndërmjet shoqërisë [REDAKTUAR] përfaqësuar nga E.G. dhe Degës së Agjencisë së Ristrukturimit dhe Privatizimit të Ndërmarrjeve Bujqësore Tiranë, me referencë ligjore VKM nr. 452, datë

17.10.1992 dhe neneve 89 dhe 182 të Kodit Civil, si dhe qëllim përdorimi dhënia me qira e sipërfaqes së tokës është 9240 m<sup>2</sup>, për një periudhë prej 99 vjet, duke filluar nga 07.12.1992, me vlerë qiraje vjetore 3049 USD, mbi të cilat subjekti ka privatizuar objektin 4 katësh të ish-stallës së lopëve dhe një ndërtesë prej betoni një katëshe të mbuluar me soletë të cilat ndodhen në ish-kompleksin blegtoral në fshatin Mucaj, nga Bashkia Vorë nuk është lidhur kontratë qiraje sipas referencave ligjore të kohës, pasi është ende në fuqi kontrata e lidhur në vitin 1994, dokument i cili u referohet akteve ligjore e nënligjore të cilat rezultojnë të ndryshuara në kohë.

**6.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Vorë, të kërkohet të azhurnohet e përditësohet kontrata bazë, me referencat ligjore të kohës dhe konkretisht VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “*Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore*”, ndryshuar me VKM nr. 735, datë 05.11.2014, VKM nr. 445, datë 20.05.2015, VKM nr. 992, datë 09.12.2015 dhe VKM nr. 299, datë 20.04.2016

## Menjëherë

**7. Gjetje nga auditimi:** Për objektin sipas kontratës datë 19.12.1992 lidhur ndërmjet shoqërisë së ndërtimit “██████████” përfaqësuar nga H.W.E.S. dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshillit të Rrethit Tiranë dhe Kryetarit të Këshillit të Komunës Vorë me referencë ligjore VKM nr. 305, datë 20.7.1992 dhe ligjin nr. 7512, datë 10.8.1991 dhe qëllim përdorimi dhënia me qira e një sipërfaqe toke prej 5 ha, për një periudhë prej 99 vjet, duke filluar nga janari 1993 deri më dhjetor 2092 për ta përdorur për ndërtimin e instalimeve e makinerive për qëllime bujqësore, prodhuese e tregtare, me vlerë qiraje vjetore 13,250 USD, është konstatuar se pavarësisht se nga subjekti është paguar rregullisht detyrimi, nga subjekti qiramarrës nuk është plotësuar qëllimi për të cilin është marrë në përdorim sipërfaqja prej 5 ha, pasi rezulton se nga ana e tij është realizuar vetëm investimi në objekte e pajisje dhe nuk realizohet asnjë aktivitet sipas kontratës.

Bashkia Vorë nuk ka lidhur kontratë qiraje sipas referencave ligjore të kohës, pasi është ende në fuqi kontrata e lidhur në vitin 1992, dokument i cili u referohet akteve ligjore e nënligjore të cilat rezultojnë të ndryshuara në kohë, si dhe është për një periudhë 99 vjeçare, kur Kodi Civil ka përcaktuar afat 30 vjeçar.

**7.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Vorë, të kërkohet të azhurnohet e përditësohet kontrata bazë, me referencat ligjore të kohës dhe konkretisht VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “*Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore*”, ndryshuar me VKM nr. 735, datë 05.11.2014, VKM nr. 445, datë 20.05.2015, VKM nr. 992, datë 09.12.2015 dhe VKM nr. 299, datë 20.04.2016, si dhe kontrata të lidhet sipas përcaktimeve kohore të bëra nga Kodi Civil.

## Menjëherë

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga Njësia Administrative Prezë, në zbatim të VKM nr. 162, datë 07.3.2007 “*Për dhënien me qira ose enfiteozë të pasurive të ndërmarrjeve, shoqërive dhe institucioneve shtetërore*”, VKM nr. 1712, datë 24.12.2008 “*Për dhënien me qira ose enfiteozë të pasurive shtetërore*”, dhe VKM nr. 529, datë 08.6.2011 “*Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore*” ka qenë lidhur kontrata për dhënien me qira të truallit dhe objekteve, nr. 680, datë 01.12.2011 lidhur ndërmjet ish-Komunës Prezë dhe ██████████ sha, për vendosjen e një stacioni antene, për sipërfaqen prej 200 m<sup>2</sup> truall dhe 35 m<sup>2</sup> ndërtim, me vlerë 360,000 lekë (ose 150 lekë/m<sup>2</sup> në muaj), kontratë e përfunduar më datë

30.05.2015). Aktualisht nga shoqëria [REDACTED] sha është paguar detyrimi edhe pse në mungesë të kontratës së re.

**8.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Vorë, të hartojë dhe nënshkruaj kontratën e re me shoqërinë [REDACTED] sha, duke respektuar të gjitha kriteret ligjore e teknike të përcaktuara në VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, ndryshuar me VKM nr. 735, datë 05.11.2014, VKM nr. 445, datë 20.05.2015, VKM nr. 992, datë 09.12.2015 dhe VKM nr. 299, datë 20.04.2016.

## Menjëherë

**9. Gjetje nga auditimi:** Për të gjitha praktikat e audituara në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, mbi lëshimin e lejeve të përdorimit (22 leje/certifikata përdorimi), është konstatuar se nuk ka Vërtetim të lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore, Sektori i Shërbimit ndaj Tatimpaguesit, ku të jetë bërë konfirmimin e situacionit përfundimtar të punimeve, pra të pasqyrojë vlerën përfundimtare të objektit, por vetëm vërtetim se subjekti nuk ka detyrime tatimore të papaguara etj.

**9.1. Rekomandim:** Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, për objektet të cilat aplikohet për pajisje me leje përdorimi, tu kërkojë subjekteve që përveç situacionit përfundimtar të paraqesin dhe situacionin e konfirmuar nga apo ti drejtohet zyrtarisht Drejtorisë Rajonale Tatimore, që për objektet për të cilat është lëshuar certifikatë përdorimi të konfirmojnë zyrtarisht vlerën përfundimtare të punimeve, sipas faturave tatimore, pasqyrave financiare dhe situacionit përfundimtar të punimeve. DPKT në rast të konstatimit të vlerave tepër, të përllogarisë diferencat për tu paguar nga secili subjekt.

## Në vijimësi

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i praktikave për pajisje me leje përdorimi u konstatua se për objektin “*Infrastruktura, godina teknike tec dhe impianti i trajtimit të ujrave te zeza wwtp*”, me subjekt investitor Shoqërinë [REDACTED] me vendndodhje investimi në Fushë-Prezë, Njësia Administrative Prezë, Bashkia Vorë, ka diferenca midis situacionit përfundimtar dhe preventivit paraprak, diferenca të cilat janë në shumën 335,726,277 lekë. Nga aplikimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë, sipas preventivit dhe situacionit përfundimtar, rezulton se detyrimi për tu paguar është në shumën prej 10,585,378 lekë, duke sjell për pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e njësisë të qeverisjes vendore Bashkia Vorë.

**10.1. Rekomandim:** Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, për pajisjen e objektit “*Infrastruktura, godina teknike tec dhe impianti i trajtimit të ujërave te zeza wwtp*”, të veprojë vetëm pasi të jetë shlyer detyrimi në vlerën prej 10,585,378 lekë, si dhe të jetë marrë konfirmim nga Drejtoria Rajonale Tatimore për vlerën përfundimtare të punimeve. Në rast të konstatimit të vijimit të ushtrimit të aktivitetit, ende pa u pajisur me leje përdorimi nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit Bashkia Vorë të zbatohen dispozitat e nenit 52 “Kundërvajtjet administrative”, pika “f”, sipas të cilit “përdorimi i objektit pa lëshimin e certifikatës së përdorimit dënohet me gjobë nga 300,000 lekë deri në 500,000 lekë” të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.

## Në vijimësi dhe për çdo rast

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga Bashkia Vorë dhe Njësitë Administrative Prezë dhe Bërxull, është konstatuar se nuk është aplikuar VKM nr. 608, datë 05.09.2012, “Për përcaktimin e

*procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme të ndërtuara deri më 10.08.1991, kur nuk posedohen akte fitimi pronësie si dhe për regjistrimin e tyre”, veprime të cilat kanë sjellë për pasojë mosregjistrimin e objekteve të banimit të përfituara sipas Dekretit nr. 5747, datë 22.7.1978, dhe nr. 7011/1985.*

**11.1. Rekomandim:** Drejtoria Planifikimit e Kontrollit dhe të Territorit, për rastet e qytetarëve të cilët kërkojnë konfirmimin e objekteve të banimit brenda zonave urbane të fshatrave, për të cilat është konstatuar se janë të pa regjistruara në ZVRPP, të procedohet me aplikimin e VKM nr. 608, datë 05.09.2012.

**Në vijimësi**

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga 32 procedura prokurimi të realizuara, në përcaktimin e kërkesave për kualifikim, formatin elektronik, nga Njësia e Prokurimit, në disa raste, nuk është kërkuar, që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në tender të paraqesin:

Vërtetim për shlyerjen e taksave e tarifave vendore në njësitë vendore ku kryejnë veprimtarinë; Numrin e nevojshëm të punonjësve, të dokumentuar nga organet tatimore me listëpagesat e sigurimeve shoqërore; Makineritë e pajisjet e nevojshme për realizimin në kohë të prokurimit; Bilancet dhe pasqyrat financiare për 3 vitet e mëparshme; Specifikimet teknike janë të përgjithshme; Licencë profesionale për tregtimin e karburantit; Certifikatë cilësie për karburantin diezel që do të furnizojë.

**12.1. Rekomandim:** Nga Njësia e Prokurimit në çdo rast në dokumentet e tenderit duhet të kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në tender të plotësojnë kërkesat për kualifikim sipas kërkesave ligjore duke kërkuar rast pas rasti plotësimin e atyre kushteve dhe kritereve të cilat mundësojnë marrjen pjesë në procedura të shoqërive që garantojnë përmbushje të kontratave në kohë dhe me cilësi.

**Në vijimësi**

**13. Gjetje nga auditimi:** Në dosjen e tenderit të zhvilluar nga Bashkia Vorë nuk ka dokument që të tregojë dhe argumentojë nevojat për karburant, marzhin e fitimit të marrë për bazë dhe përcaktimin e fondit limit, specifikimet teknike dhe karakteristikat fiziko-kimike të karburantit dhe sasinë e karburantit, të nevojshëm, në kundërshtim me kërkesat e nenit 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**13.1. Rekomandim:** Për një përdorim me efikasitet të fondeve publike, të argumentohet domosdoshmëria e kryerjes së prokurimit me përcaktimin me përgjegjësi dhe nga persona kompetentë të sasive që do të prokurohen, me leverdinë ekonomike dhe volumet efektive të punëve që do të kryhen dhe të përcaktohen hollësisht specifikimet teknike, në zbatim të nenit 59 kreu VII “Zyrtarët e prokurimit dhe zhvillimi i procedurave”, miratuar me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**Në vijimësi**

**14. Gjetje:** Dosjet teknike të 4 investimeve të audituara rezultuan me mangësi në dokumentacion, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 4, paragrafi 4.

**14.1. Rekomandim:** Bashkia Vorë, nëpërmjet Drejtorisë së Planifikimit të Territorit, të marrë masa për plotësimin e dokumentacionit të dosjeve teknike të investimeve gjatë procesit të zbatimit të kontratave, deri në dorëzimin e objektit.

**Në vijimësi**

**15. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i Zyrës së Taksave e Tarifave Vendore, për periudhën deri më datë 30.6.2016, rezultoi se për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë (subjektet e biznesit të vogël, biznesit të madh dhe taksat e tarifave familjare), **në vlerën prej 78,395 mijë lekë** gjithsej, nga ku përfshihen:

-debitorët e biznesit të vogël për taksat dhe tarifave vendore **në shumën 4,753 mijë lekë;**

-debitorët e biznesit të madh për detyrimet e taksave e tarifave vendore në vlerën **53,576 mijë lekë;**

-detyrimet e subjekteve të pa regjistruara **në shumën 715 mijë lekë.**

-detyrimet për debitorët familjarë për shlyerjen e taksave e tarifave vendore për vlerën **19,251 mijë lekë**, nga e cila për vitin 2014 janë **404** mijë lekë, për vitin 2015 janë **10,662** mijë lekë dhe për vitin 2016 janë **8,185** mijë lekë.

**15.1. Rekomandim:** Nga ana e Sektorit të Taksave e Tarifave Vendore, të merren masa për arkëtimin e detyrimeve debitorë të pa arkëtuara në vlerën **59,144 mijë lekë për sektorin e biznesit dhe të vlerës 19,251 mijë lekë për popullatën.**

**Në vijimësi**

**16. Gjetje:** Inspektorati i Mbrojtjes të Territorit, Bashkia Vorë gjatë 2015, për 10 subjekte, ka vendosur gjobë në vlerën totale prej 8,000,000 lekë, për të cilat pasi janë shpallur titull ekzekutiv ka filluar procesi i kërimit të tyre me procedura përmbartimore dhe nga ku rezulton se janë në proces ekzekutim. Gjatë vitit 2016, për 8 subjekte, ka vendosur gjobë në vlerën totale prej 4.050.000 lekë, vlerë për të cilën ka filluar procesi i ekzekutimit nga përmbartuesi gjyqësor privat.

**16.1. Rekomandim:** Bashkia Vorë, nëpërmjet Zyrës Juridike dhe Drejtorisë Ekonomike, të ndjek proceset gjyqësore ndaj subjekteve të cilat kanë ankimuar gjyqësish masën e gjobës, si dhe subjekteve të cilat nuk e kanë ushtruar këtë të drejtë, dhe ende nuk kanë filluar shlyerjen e gjobës.

**16.2. Rekomandim:** Bashkia Vorë të ndjek në mënyrë të vazhdueshme duke i kërkuar Zyrës së Shërbimit Përmbartimor, ecurinë e arkëtimin të vlerës prej 8,000,000 lekë për vitin 2015 dhe 4,050,000 lekë për vitin 2016, vlerë e cila përbën të ardhura të munguar për buxhetin e NJQV Bashkia Vorë. Në referim të rezultateve konkrete të punës të Zyrës të Shërbimit Përmbartimor, në drejtim të arkëtimin të shumës prej 12,050,000 lekë të rishikoj sipas rastit marrëdhëniet e bashkëpunimit, deri në prishjen e kontratës.

**Në vijimësi**

**17. Gjetje nga auditimi:** *Realizimi i rekomandimeve dhe detyrave të lëna nga KLSH paraqitet si më poshtë:*

- **Masa organizative.** Janë rekomanduar 11 masa organizative, prej të cilave janë zbatuar plotësisht 10 masa organizative dhe 1 masë organizative, pika 3, është realizuar pjesërisht, pasi aktualisht mbledhja e detyrimeve për taksat e tarifave vendore është realizuar pjesërisht, si për subjektet private me status biznesi i vogël, biznesi i madh, apo familjarë.

- **Masa për shpërblim dëmi.** Janë rekomanduar 7 masa për shpërblim dëmi për në vlerën 2,465,405 lekë, prej të cilave deri më datën 30.6.2016 janë realizuar 4 masa shpërblim dëmi në shumën gjithsej 1,903,576 lekë, janë bërë njoftimet përkatëse për detyrimet e operatorit ekonomik [REDACTED], për shumën 56,551 lekë, për të cilat nuk ka arkëtim, si dhe nuk është zbatuar rekomandimi 7 për marrëdhëniet me ish punonjësen M.Q.

**17.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Vorë të merren masat për mbledhjen e debitorëve të biznesit të vogël e të madh, por dhe debitorët familjarë të evidentuar nga auditimi i mëparshëm.

Të realizohen masat shpërblim dëmi me operatorin ekonomik “██████████” dhe ish punonjësen znj. M.Q.

**Menjëherë**

## **B. MASA SHPËRBLIM DËMI**

Mbështetur në pikën 5 neni 13, pika 14 neni 43, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109 dhe udhëzimin e Ministrit të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kap IV, -Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, **nga ana e titullarit të njësisë publike**, (Nëpunësit Autorizues), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, shpenzime tw . **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare me qëllim për shpërblimin e dëmit në vlerën **8,474,968 lekë dhe 3049 USD**, si më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi:** Në objektin “**Sistemim-Asfaltim i Rrugës Pavarësia Fshati Sharge**”, Bashkia Vorë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes së punimeve të ndërtimit si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të situacionuara deri në momentin e inspektimit (*punimet ishin në proces*) rezultuan diferenca në punime të pa kryera në fakt, por të **situacionuara më tepër në vlerën 3,312,200 lekë pa tvsh**, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 3.2 dhe 3.3, kontratën për mbikëqyrjen e punimeve lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Vorë dhe mbikëqyrësit të punimeve ing. B.D, neni 4 dhe neni 6 pika 1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pika 8.1 dhe 8.3, Udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pikat 3.

**1.1.Rekomandim:** Nga Bashkia Vorë përpara marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve të përfunduara, të merren masa për verifikimin e zërave të punimeve të konstatuara me mangësi gjatë inspektimit në terren. Konkretisht u konstatuan si punime të të pakryera me vlerë **3,312,200 lekë pa tvsh** nga BOE “██████████” shpk & “██████████” shpk, në cilësinë e sipërmarrësve në kontratën nr. 73/5, datë 06.05.2015 me objekt “**Sistemim-Asfaltim i Rrugës Pavarësia Fshati Sharge**”, Bashkia Vorë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

**Menjëherë**

**2. Gjetje nga auditimi:** Në objektin “**Sistemim-Asfaltim i Rrugës Kodra e Xhirajve, Fshati Marqinet**”, Bashkia Vorë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes së punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga

verifikimi në terren rezultuan diferenca më tepër në vlerë, në vlerën **880,390 lekë pa tvsh duke shkaktuar dëm ekonomik, nga të cilat vlera 317,250 lekë pa tvsh për punime të pakryera në fakt dhe vlera 563,140 lekë pa tvsh si pasojë e ndryshimit të zërave pa u shoqëruar me çmimin përkatës. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 3.2 dhe 3.3, kontratën për mbikëqyrjen e punimeve lidhur me Autoritetit Kontraktor Bashkia Vorë dhe mbikëqyrësit të punimeve ing. B.D. neni 4 dhe neni 6 pika 1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pika 8.1 dhe 8.3, Udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pikat 3.**

**2.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Vorë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **880,390 lekë pa tvsh** nga OE “” shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 69/6, datë 06.05.2015 me objekt “**Sistemim-Asfaltim i Rrugës Kodra e Xhirajve, Fshati Marqinet**”, Bashkia Vorë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera.

**Menjëherë**

**3. Gjetje nga auditimi:** Në objektin “**Rikonstruksion dhe Asfaltim i Rrugëve të Lagjeve në Kodër Vorë, Loti 1**”, Bashkia Vorë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes së punimeve të ndërtimit si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të situacionuara deri në momentin e inspektimit (*punimet ishin në proces*) rezultuan diferenca në punime të pa kryera në fakt, por të **situacionuara më tepër në vlerën 2,796,400 lekë pa tvsh**, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 3.2 dhe 3.3, kontratën për mbikëqyrjen e punimeve lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Vorë dhe mbikëqyrësit të punimeve ing. B.D. neni 4 dhe neni 6 pika 1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pika 8.1 dhe 8.3, Udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pikat 3.

**3.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Vorë përpara marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve të përfunduara, të merren masa për verifikimin e zërave të punimeve të konstatuara me mangësi gjatë inspektimit në terren. Konkretisht u konstatuan si punime të pakryera me vlerë **2,796,400 lekë pa tvsh** nga OE “” shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 81/5, datë 16.12.2015 me objekt “**Rikonstruksion dhe Asfaltim i Rrugëve të Lagjeve në Kodër Vorë, Loti 1**”, Bashkia Vorë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

**Menjëherë**

**4. Gjetje nga auditimi:** Në objektin “**Rikonstruksion Sistemim dhe Asfaltim i Rrugëve të Brendshme të Fshatit Muçaj, Aksi 01**”, Bashkia Vorë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes së punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan diferenca më tepër në vlerën **1,292,538**

**lekë pa tvsh duke shkaktuar dëm ekonomik, për punime të pakryera në fakt.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit””, pika 3.2 dhe 3.3, kontratën për mbikëqyrjen e punimeve lidhur me Autoritetit Kontraktor Bashkia Vorë dhe mbikëqyrësit të punimeve ing. K.S. neni 4 dhe neni 6 pika 1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pika 8.1 dhe 8.3, Udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pikat 3.

**4.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Vorë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,292,538 lekë pa tvsh** nga BOE “██████████” shpk & “██████████” shpk, në cilësinë e sipërmarrësve në kontratën nr. 214/5, datë 09.01.2015 me objekt “**Rikonstruksion Sistemim dhe Asfaltim i Rrugëve të Brendshme të Fshatit Muçaj, Aksi 01**”, Bashkia Vorë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera.

**Menjëherë**

**5. Gjetje nga auditimi:** Sipas vendimit të Këshillit të Bashkiak, për nivelin e shpërblimit të anëtarëve të këshillit bashkiak për pjesëmarrjen në mbledhjet e këshillit, është aplikuar masa e shpërblimit në nivelin 10% të pagës Kryetarit të Bashkisë, ose 7,020 lekë në muaj. Në listëprezencën e pjesëmarrjes të këshilltarëve të dërguar nga Sekretari i Këshillit në Zyrën e Financës, për kryerjen e pagesave të këshilltarëve, janë përfshirë edhe 15 këshilltarë të cilët edhe pse nuk kanë frekuentuar mbledhjet e këshillit rezultojnë të jenë paguar, duke ku si pasojë përfitimin më tepër të shumës në vlerën prej **193,440 lekë**.

**5.1. Rekomandim:** Zyra e Financës në Bashkinë Vorë të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **193,440 lekë, nga 15 këshilltarët**, si më poshtë:

1. A.U.	33930 lekë	2. R.M.	35 580 lekë
3. R.H.	6 630 lekë	4. N.K.	6 630 lekë
5. A.P.	13 260 lekë	6. K.M.	6 630 lekë
7. V.Sh.	6 630 lekë	8. S.K.	7 650 lekë
9. B.H.	15 300 lekë	10. Sh.S.	7 650 lekë
11. N.S.	22 950 lekë	12. F.G.	7 650 lekë
13. L.L.	7 650 lekë	14. K.I.	7 650 lekë
15. E.M.	7 650 lekë		

**Menjëherë**

**6. Gjetje nga auditimi:** Për objektin sipas kontratës datë 01.06.1994 lidhur ndërmjet shoqërisë “██████████” përfaqësuar nga E.G. dhe Degës së Agjencisë së Ristrukturimit dhe Privatizimit të Ndërmarrjeve Bujqësore Tiranë, me referencë ligjore VKM nr. 452, datë 17.10.1992 dhe neneve 89 dhe 182 të Kodit Civil dhe qëllim përdorimi dhënia me qira e sipërfaqes së tokës është 9240 m<sup>2</sup>, në fshatin Muçaj, për një periudhë prej 99 vjet, duke filluar nga 07.12.1992, është konstatuar se nuk është paguar detyrimi prej **3049 USD**.

**6.1. Rekomandim 1:** Nga Bashkia Vorë, të merren të gjitha masat dhe të aplikohen të gjitha procedurat për kërkimin e vlerës të kontratës së qirasë, si dhe të kërkohet të zbatohet pika e kontratës sipas të cilës për çdo ditë vonesë shoqëria duhet të paguaj penalitetet në vlerën prej 1% për çdo ditë, kamatëvonesë e cila llogaritet mbi nivelin bazë të qirasë.

**Menjëherë**

## C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenet 58, germa a, b, c, ç, “Llojet e masave disiplinore” dhe 59 “Kompetencat dhe procedurat për masat disiplinore” të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendim-marrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe në nenin 64 germat “g” dhe “k” të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i rekomandojmë Titullarit pranë njësisë të vetëqeverisjes vendore, Bashkisë Vorë t’i kërkojë Komisionit Disiplinor, të klasifikojë shkeljet e konstatuara, në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe të fillojnë ecurinë disiplinore për marrjen e masave disiplinore, nga masa “Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil”, për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Statusin e Nëpunësit Civil, si më poshtë:

1. **z. A.S.** Përgjegjës i Sektorit të taksave e Tarifave
2. **znj. A.H.** specialist në Sektorin e Taksave e Tarifave
3. **znj. G.A.** specialist në Sektorin e Taksave e Tarifave
4. **B.M.** specialist në Sektorin e Taksave e Tarifave

### **Për arsye se:**

Nga auditimi i të dhënave të Zyrës së Taksave e Tarifave Vendore konstatohet se deri në datën 30.6.2016 rezultoi se për mospagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë (subjektet e biznesit të vogël, biznesit të madh dhe taksat e tarifave familjare), **në vlerën prej 78,395 mijë lekë** gjithsej.

Në vlerën e mësipërme për periudhën objekt auditimi, përfshihen:

-debitorët e biznesit të vogël për taksat dhe tarifave vendore **në shumën 4,753 mijë lekë**, ku përfshihet detyrimi i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin;

-debitorët e biznesit të madh për detyrimet e taksave e tarifave vendore në vlerën **53,576 mijë lekë**;

-detyrimet e subjekteve të pa regjistruara **në shumën 715 mijë lekë**.

-detyrimet për debitorët familjarë për shlyerjen e taksave e tarifave vendore për vlerën **19,251 mijë lekë**, nga e cila për vitin 2014 janë **404** mijë lekë, për vitin 2015 janë **10,662** mijë lekë dhe për vitin 2016 janë **8,185** mijë lekë

Nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Vorë, u konstatuan mangësi dhe shkelje të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM Nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Bazuar në germën “ç” të nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i kërkojmë Titullarit të Autoritetit Kontraktor (Kryetarit të Bashkisë Vorë)**, që në zbatim të pikës 2, të nenit 72 “Kundërvajtjet administrative”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 81 “Masat disiplinore”, Kreu XI “Sanksionet administrative dhe masat disiplinore”, të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të shqyrtojë dhe të marrë masa disiplinore ndaj **anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe specialistëve të Njësisë së Prokurimit sipas përgjegjësisë përkatëse në Raportin Përfundimtar të Auditimit, e konkretisht:**

- 5. z. B.C.** me detyrë përgjegjëse i Sektorit Juridik, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave,
- 6. z. L.B.** me detyrë Drejtor i DPKZHT, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave,
- 7. znj. A.D.** me detyrë përgjegjëse e Sektorit të Financës, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave,
- 8. z. F.P.** me detyrë specialist, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në ish Komunën Bërzhitë.

***Për arsye se:***

Kanë kualifikuar dhe shpallur fitues operator ekonomik kur dokumentacioni i paraqitur për të vërtetuar kapacitetet ekonomike, financiare dhe teknike është në kundërshtim me DST (Kriteret e Veçanta të Kualifikimit), nenin 46 dhe 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Kreun V, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për Rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar dhe Kreun VII, të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

- 9. znj. O.S.** me detyrë juriste, në cilësinë e Juristit të Njesisë së Prokurimit,
- 10. znj. E.A.** me detyrë juriste, në cilësinë e Juristit të Njesisë së Prokurimit,
- 11. z. A.D.** me detyrë specialist në DPKZHT, në cilësinë e specialistit në Njesisë e Prokurimit,
- 12. znj. A.K.** me detyrë specialist, në cilësinë e specialistit në Njesisë e Prokurimit,

***Për arsye se:***

-Nuk kanë dhënë argumente të hollësishme mbi arsyet e vendosjes së çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me kreun III “Dokumentet e tenderit”, të miratuara me Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 10.01.2007 dhe VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se, për vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, të parashikuar në Ligjin e Prokurimeve Publike dhe në këto rregulla, njësia duhet të argumentojë me hollësi vendosjen e tyre, sipas natyrës dhe vëllimit të kontratës, duke nxitur pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik, veçanërisht biznesit të vogël. Kriteret jo përpjesëtimore e të ekzagjeruar kanë çuar në rritjen e kostos së punëve, mallrave dhe shërbimeve, për rrjedhojë autoriteti kontraktor ka paguar më shumë në kualifikimin e ofertuesve dhe përzgjedhjen e ofertuesit fitues, pa arritur efektivitet ekonomik në realizimin e prokurimeve.

## **D. MASA ADMINISTRATIVE**

**1.** Nga Bashkia Vorë të merren masa që në mbështetje të ligjit nr. 8402 dt. 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16, t’i kërkojë Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, **të vendosë masë administrative me gjobë në masën 200,000 lekë për Ing. B.D.** në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara si më poshtë:

- Në procedurat e zbatimit të kontratës me objekt “**Sistemim-Asfaltim i Rrugës Pavarësia Fshati Sharge**”, Bashkia Vorë, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore **në vlerën 3,312,200 lekë pa tvsh për punime të pakryera në fakt.** Veprime këto në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar.

- Në procedurat e zbatimit të kontratës me objekt **“Sistemim-Asfaltim i Rrugës Kodra e Xhirajve, Fshati Marqinet”**, Bashkia Vorë, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore në vlerën **880,390 lekë pa tvsh për punime të pakryera në fakt**. Veprime këto në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 *“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”*, i ndryshuar.

- Në procedurat e zbatimit të kontratës me objekt **“Rikonstruksion dhe Asfaltim i Rrugëve të Lagjeve në Kodër Vorë, Loti 1”**, Bashkia Vorë, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore në vlerën **2,796,400 lekë pa tvsh për punime të pakryera në fakt**. Veprime këto në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 *“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”*, i ndryshuar.

**Menjëherë**

**2.** Nga Bashkia Vorë të merren masa që në mbështetje të ligjit nr. 8402 dt. 10.09.1998 *“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”*, i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16, t’i kërkojë Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, **të vendosë masë administrative me gjobë në masën 100,000 lekë për Ing. K.S.** nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara si më poshtë:

- Në procedurat e zbatimit të kontratës me objekt **“Rikonstruksion Sistemim dhe Asfaltim i Rrugëve të Brendshme të Fshatit Muçaj, Aksi 01”**, Bashkia Vorë, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore në vlerën **1,292,538 lekë pa tvsh për punime të pakryera në fakt**. Veprime këto në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 *“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”*, i ndryshuar.

**Menjëherë**

**3.** Nga Bashkia Vorë të merren masa që në mbështetje të ligjit nr. 8402 dt. 10.09.1998 *“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”*, i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16, t’i kërkojë Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, **të vendosë masë administrative me gjobë në masën 50,000 lekë për Ing. T.S.** nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara si më poshtë:

- Në procedurat e zbatimit të kontratës me objekt **“Rikonstruksion Sistemim dhe Asfaltim i Rrugëve të Brendshme të Fshatit Muçaj, Aksi 01”**, Bashkia Vorë, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore në vlerën **1,292,538 lekë pa tvsh për punime të pakryera në fakt**. Veprime këto në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 *“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”*, i ndryshuar.

**Menjëherë**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor.

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**